




BASHKIA TIRANE
DREJTORIA E PUNEVE PUBLIKE

MIRATOI
KRYETAR
ERION VELIAJ
VKT Nr. Date ___ / ___ / ___

Titulli Projektit:	“Nderhyrje Emergjente ne Rrugen “Rexhekri”, Fshati Surrel, Nj. A Dajt	
-------------------------------	--	--

**Titulli
Dokumentit:**

RAPORT TEKNIK



Konst. Ing. Dhimitri PAPA

Nr.Liç. K.1510/2

1. QELLIMI

Qellimi i ketij dokumenti eshte jape specifikimet teknike te materialeve te cilat do te perdoren per realizimin e strukturese se objektit **“Nderhyrje Emergjente ne Rrugen “Rexhekri”, Fshati Surrel Nj.A. Dajt”**. Materialet qe do te perdoren per projektimin e struktur'es (betoni dhe celiku) duhet te plotesojne te gjitha kriteret e parashikuara ne KTP si dhe ato te Parashikuara ne Eurokode.

- Betoni i derdhur ne vend

- Kerkesa te përgjithshme per betonet

Betoni eshtë një përzierje e cimentos, inerte të fraksionuara të rërës, inerte të fraksionuara të zhavorit dhe ujit dhe solucioneve të ndryshme për fortësinë, përshkueshmërinë e ujit dhe për të bërë të mundur qe të punohet edhe ne temperatura të ulëta sipas kërkave dhe nevojave teknike të projektit.

- Materialet

• Përbërësit e Betonit

Përbërësit e betonit duhet te përmajnë rërë te larë ose granal, ose përzierje te te dyjave si dhe gurë te thyer. Te gjithë aggregatet duhet te jenë pastruar nga mbeturinat organike si dhe nga dheu. Pjesa kryesore e aggregateve duhet te jetë me formë këndore dhe jo te rrumbullakët. Përbërësit e betonit duhet te kenë çertifikatën qe vërteton vendin ku janë marrë ato.

• Çimento

Kontraktuesi eshtë i detyruar qe për çdo ngarkesë çimentoje te prurë ne objekt, te paraqesë faturën e blerjes e cila te përbajë: sasinë, emrin e prodhuesit si dhe çertifikatën e prodhuesit dhe shërben për të treguar qe çimentoja e secilës ngarkesë eshtë e kontrolluar dhe me analiza sipas standardeve.

• Uji per beton

Uji qe do te perdoret ne prodhimin e betonit duhet te jetë i pastër nga substancat qe dëmtojnë atë si: acidet, alkalidet, argila, vajra si dhe substanca te tjera organike. Ne përgjithësi, uji i tubacioneve te furnizimit te popullsisë (uji i pijshëm) rekomandohet per përdorim ne prodhimin e betonit ose uje i puseve pasi ti jene bere analizat laboratorike.

- Depozitimi i materialeve


Depozitimi i materialeve qe do te perdoren per prodhimin e betonit duhet te plotesojë kushtet e mëposhtme:

- Çimentoja dhe përbërësit duhet te depozitojen ne atë mënyrë qe te ruhen nga përzierja me materiale te tjera, te cilat nuk janë te përshtatshme per prodhimin e betonit dhe e dëmtojnë cilësinë e tij.
- Çimentoja duhet te depozitojet ne ambiente pa lagështirë dhe qe nuk lejojnë lagjen e saj nga uji dhe shirat.

-Betoni

Marka 300 me inerte, konsistencë 3 – 5 cm, granal deri ne 20 mm, rërë e larë me modul 2,6: Çimento marka 400, 465 kg, rërë e larë 0,38 m³, granal 0,64 m³, uje 0,195 m³.

Betoni Bazuar te EC8, në strukturat me duktilitet mesatar DCM, nuk mund të përdoret, per elementet paresore sizmike beton me klase me te vogel se C16/20. Betoni i klasës (C25/30) do të përdoret per realizmin e themelive me pilota dhe mureve mbajtese.



Parametrat e betonit të pa-shtrënguar (C20/25) dhe (C25/30).

Material Property Data


<p>Material Name CONC</p> <p>Type of Material <input checked="" type="radio"/> Isotropic <input type="radio"/> Orthotropic</p> <p>Analysis Property Data</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td>Mass per unit Volume</td> <td>2.4517</td> </tr> <tr> <td>Weight per unit Volume</td> <td>25.</td> </tr> <tr> <td>Modulus of Elasticity</td> <td>30000000.</td> </tr> <tr> <td>Poisson's Ratio</td> <td>0.17</td> </tr> <tr> <td>Coeff of Thermal Expansion</td> <td>9.900E-06</td> </tr> <tr> <td>Shear Modulus</td> <td>12820512.8</td> </tr> </table>	Mass per unit Volume	2.4517	Weight per unit Volume	25.	Modulus of Elasticity	30000000.	Poisson's Ratio	0.17	Coeff of Thermal Expansion	9.900E-06	Shear Modulus	12820512.8	<p>Display Color Color</p> <p>Type of Design Design Concrete</p> <p>Design Property Data (Eurocode 2-2004)</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td>Charact. Conc Cyl Strength, fck</td> <td>27579.0315</td> </tr> <tr> <td>Bending Reinf. Yield Stress, fyk</td> <td>413685.48</td> </tr> <tr> <td>Shear Reinf. Yield Stress, fywk</td> <td>413685.48</td> </tr> <tr> <td><input type="checkbox"/> Lightweight Concrete</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Shear Strength Reduc. Factor</td> <td></td> </tr> </table>	Charact. Conc Cyl Strength, fck	27579.0315	Bending Reinf. Yield Stress, fyk	413685.48	Shear Reinf. Yield Stress, fywk	413685.48	<input type="checkbox"/> Lightweight Concrete		Shear Strength Reduc. Factor	
Mass per unit Volume	2.4517																						
Weight per unit Volume	25.																						
Modulus of Elasticity	30000000.																						
Poisson's Ratio	0.17																						
Coeff of Thermal Expansion	9.900E-06																						
Shear Modulus	12820512.8																						
Charact. Conc Cyl Strength, fck	27579.0315																						
Bending Reinf. Yield Stress, fyk	413685.48																						
Shear Reinf. Yield Stress, fywk	413685.48																						
<input type="checkbox"/> Lightweight Concrete																							
Shear Strength Reduc. Factor																							
<input type="button" value="OK"/>	<input type="button" value="Cancel"/>																						

Parametrat e betonit të modeluar gjate llogaritjeve kompjuterike

Parametrat e betonit të pa-shtrënguar (C25/30)

Beton C25/30

$$f_{ck} = 25 \text{ kN/cm}^2, f_{cd} = 14.16 \text{ kN/cm}^2, \gamma_c = 1.5, \varepsilon_{cy} = 0.20\%, \varepsilon_{cu} \geq 0.35\%$$



BETON PER MBISTRUKTUREN

Strength class of concrete C 25/30

Maximum dimension of aggregate $D_{max} = 25 \text{ mm}$, Concrete cover 50 mm

Cubic strength at 28 days $f_{ck,cube} \geq 25 \text{ MPa}$, Cylindrical strength at 28 days $f_{ck,cyl} \geq 30 \text{ MPa}$

Strength at ULS $f_{cd} = 14.16 \text{ MPa}$, Tensile strength at ULS $f_{ctd} = 1.59 \text{ MPa}$

Elastic Modulus $E_c = 27\,000 \text{ MPa}$

Parametrat e betonit të pa-shtrënguar (C25/30) jepen ne tabelen e meposhtme:

Klasa e Rezistences se Betonit	C25/30MPa
Rezistenca Karakteristike Cilindrike	$f_{ck} = 25 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike Kubike	$R_{ck} = 25 \text{ MPa} (f_{ck,cube})$
Rezistenca Mesatare ne Shtypje (28 ditore)	$f_{cm} = f_{ck} + 8 = 25 + 8 = 32 \text{ MPa}$
Rezistenca Mesatare ne Terheqje (≤C50/60)	$f_{ctm} = 0.3 \cdot f_{ck}^{2/3} = 3.2 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike ne Terheqje	$f_{ctk}(5\%) = 0.7 \cdot f_{ctm} = 2.24 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike ne Terheqje	$f_{ctk}(95\%) = 1.3 \cdot f_{ctm} = 4.16 \text{ MPa}$
Moduli Sekant i Elasticitetit te Betonit	$E_{cm} = 22[(f_{cm})/10]^{0.3} = 31 \text{ GPa}$
Moduli i Elasticitetit (Vlera Llogaritese)	$E_{cd} = E_{cm} / \gamma_c E = 31 / 1.2 = 25.8 \text{ GPa}$
Koeficientet e Sigurise Parciale te Betonit	$\gamma_c = 1.5 \quad \alpha = 0.85$
Rezistenca Llogaritese ne Shtypje (SLU)	$f_{cd} = \alpha \cdot f_{ck} / \gamma_c = 14.16 \text{ MPa}$
Rezistenca Llogaritese ne Terheqje (SLU)	$f_{ctd} = f_{ctk}(5\%) / \gamma_c = 1.59 \text{ MPa}$
Koeficienti i Puassonit	$\nu = 0.20$
Klasa e ekspozimit UNI EN 206-6	XC4/XF4
Klasa e Konsistencies	S4

Beton –C20/25 (Marka 250)

$$f_{ck} = 2.0 \text{ kN/cm}^2, f_{cd} = 1.389 \text{ kN/cm}^2, \gamma_c = 1.5, \varepsilon_{cy} = 0.20\%, \varepsilon_{cu} = 0.35\%$$


Betoni C12 / 15 do të përdoret si shtresë e varfer pastertie nën themel. Nuk përdoret si beton strukturor dhe të dhënat e tij janë përfshirë më poshtë.

CELIKU I BETONARMESE

Celiku që do të përdoret duhet të gjëzojë veti të mira si në rezistencë ashtu edhe në deformueshmëri (duktilitet). Në elementët parësorë sizmike, për armaturën e hekurit duhet të përdoret çelik i klasës B ose C, sipas tabelës C1 në Aneksin Normativ C të Eurokodit 2, EN 1992.

Celik – S500, $f_{ys} = 50000 \text{ kN/m}^2$, $f_{us} = 60000 \text{ kN/m}^2$, $E = 20000000 \text{ kN/m}^2$

$\gamma_s = 1.15$, $\varepsilon_{sy} = 0.25\%$, $\varepsilon_{su} \geq 10.0\%$



Çelik – S500
$f_{ys} = 50000 \text{ kN/m}^2$
$f_{us} = 60000 \text{ kN/m}^2$
$E = 20000000 \text{ kN/m}^2$
$\gamma_s = 1.15$
$\varepsilon_{sy} = 0.25\%$
$\varepsilon_{su} \geq 10.0\%$




Figura 1: Diagrama sforcim-deformim e çelikut B500C

Më siper jepen karakteristikat dhe diagrama e çelikut të përdorur në strukturë. Referuar eurokodeve shufrat e çelikut duhet të jenë patjetër të vjaskuara (çelik periodik).

Armatura e Betonarmese (EN 10080 Steel for the Reinforcement of Concrete)

Klasi e Çelikut te Zakonshem	B500C
Rezistenca Karakteristike e Rrjedhshmerise	$f_yk = 500 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike e Shkaterrimit	$f_tk = 600 \text{ MPa}$
Moduli i Elasticitetit	$E_s = 210 000 \text{ MPa} = 210 \text{ GPa}$
Koeficienti i Sigurise Parciale te Celikut	$\gamma_s = 1,15$
Rezistenca Llogariteze e Celikut	$f_yd = f_yk / \gamma_s = 435 \text{ MPa}$
Rezistenca Llogariteze e Celikut ne Prerje	$F_ywd = 500 \text{ MPa}$
Koeficienti i Puassonit	$\nu = 0.30$

CELIKU PER ARMIMIN E KONSTRUKSIONIT BETON ARME (STEEL FOR REBAR B500C)

Characteristic breaking stress $f_tk = 600 \text{ MPa}$

Characteristic yielding stress $f_yk = 500 \text{ MPa}$

Characteristic ratio breaking/yielding $1.3 \leq (f_t/f_y)k \leq 1.35$

Elastic Modulus $E = 210 \text{ Gpa}$, Elongation $\geq 12\%$

Perberja Kimike (%) per celikun B500C					
C (Karbon)	N (Azot)	P (Fosfor)	S (Squfur)	Cu (Baker)	CEV
0.22	0.012	0.05	0.05	0.80	0.50

- Mbrojtja

Betoni i freskët duhet mbrojtur nga këto ndikime:

- Shiu si dhe lagështi të tjera duke e mbuluar sipërfaqen e betonuar me plastmas dhe materiale të padepërtueshme nga uji
- Ngricat (duke i futur gjatë proçesit të prodhimit solucione kundra temperaturave të ulta mundet të betonohet deri në temperaturën afër zeros.
- Temperatura të larta. Betoni mbrohet ndaj temperaturave të larta duke e lagur vazhdimisht atë me ujë, në mënyrë të tillë që të mos krijohen plasaritje

- Betoni në kushte të vështira atmosferike

- Rekomandohet që prodhimi dhe hedha e betonit në objekt të mos realizohet në kushte të vështira atmosferike.
- Ndalohet prodhimi dhe hedha e betonit në rast se bie shi i rrëmbyeshëm, pasi nga sasia e madhe e ujit që i futet betonit largohet çimentoja dhe kështu që betoni e humb markën që kërkohet.
- Në rastet e temperaturave të ulta nën 4°C rekomandohet të mos kryhet betonimi, por n.q.s kjo është e domosdoshme, atëherë duhet të merren masa që gjatë proçesit të prodhimit të betonit, atij t'i shtohet solucioni ndaj ngricave në masën e nevojshme që rekomandohet nga prodhuesi i këtij solicioni.
- Prodhimi dhe përpunimi i betonit në temperaturat e larta mund të ndikojë negativisht në reagimin kimik të cimentos me pjesët e tjera të betonit. Për këtë arsyen duhet ruajtur kundër temperaturave të larta. Mënyra e ruajtjes nga temperatura e lartë mund të bëhet në atë mënyrë, që betoni i freskët të mbrohet nga dielli duke e mbuluar me plasmas, tallash dhe duke e stërkatur me ujë. Një ndihmë tjetër për përpunimin e betonit në temperaturat e larta është të ngjyrosësh mbajtësit e ujit me ngjyrë të bardhë dhe të sigurojë spërkatje të vazhdueshme me ujë.
- Tuba dhe dalje. Tubat si dhe kanalet e ndryshme që e furnizojnë një ndërtësë (uji, ujërat e zeza, rrjeti elektrik, etj) duhet sipas mundësisë të mos futen në beton, që mos pengojnë në homogenitetin e pjesëve të betonit të cilat janë projektuar si pjesë mbajtëse, elemente betoni. Në rastet, kur ky kusht nuk mund të plotësohet, atëherë duhet konsultuar inxhinieri perfaqesues te investitorit.

- Provat e betonit

Pasi është prodhuar betoni, ai duhet kontrolluar nëse i plotëson kriteret sipas kërkesave të projektit. Mbasi të prodhohet ai dhe para hedhjes së tij, duhet marrë një kampion betoni për të bërë testime në laborator dhe rezultatet e laboratorit duhet të dorëzohen tek inxhinieri perfaqesues i investitorit.

- Hekuri

- Përgatitja e çelikut për të gjitha strukturat e betonit dhe komponentët e metalit, që duhen prodhuar në kantier, duke konsideruar çelikun që plotëson të gjitha kërkesat e projektit dhe pa prezencën e ndryshkut, në format dhe përmasat sipas vizatimeve dhe standardeve tekniko-legale për bashkimin, lidhjen dhe duke e shoqëruar me certifikatën e prodhuesit për të verifikuar që çeliku plotëson kushtet e kërkua të nevojiten për punë të tillë dhe duke përfshirë të gjitha kërkesat e tjera jo të specifikuara.

- **Depozitimi në kantier**

- Depozitimi i hekurit në kantier duhet të bëhet i tillë, që të mos dëmtohet (shtrëmbërohet, pasi kjo gjë do të shtonte proçesin e punës së shtrimit) si dhe të mos pengojë punimet ose materialet e tjera të ndërtimit

- **Kthimi i hekurt**

a) Hekurat duhen kthyer sipas dimensioneve të treguara në projekt.

b) Të gjitha shufrat duhen kthyer dhe kthimi duhet bërë ngadalë, drejt dhe pa ushtrim force. Bashkimet e nxehta nuk lejohen.

c) Prerja me oksijen e shufrave shumë të tendosshme do të lejohet vetëm me aprovimin e inxhinierit perfaqesues te investitorit.

- **Vendosja dhe fiksimi**

Hekurat do të pozicionohen siç janë paraqitur në projekt dhe do të ruajnë këtë pozicion edhe gjatë betonimeve. Për të siguruar pozicionin e projektit ata lidhen me tel 1,25 mm.

- **Mbulimi I hekurt**

Termi mbulimi në këtë rast do të thotë minimumn e pastër të shtresës mbrojtëse ndërmjet sipërfaqes së hekurave dhe faqes së betonit e cila varet nga specifikimi ne projekt.

- **Xhuntime e hekurave**

Xhunimi i shufrave të hekurt do të bëhet vetëm sipas vizatimeve të treguara.

BETONIMI I PILOTES DHE SPECIFIKIME TEKNIKE

- Betonimi i pilotes duhet te behet i panderprere.
- Kontraktori duhet të marrë të gjitha masat paraprake në projektimin e recetës dhe hedhjen e betonit për të shmangur lidhjen e betonit me kemishat provizore te pilotave si edhe per te garantuar qe betoni i hedhur nuk do te ndotet nga dheu, ose materiale te tjere te huaj.
- Konsistencë e betonit duhet të jetë në përputhje me specifikimet qe shenohen ne projekt dhe metoda e derdhjes se betonit duhet të jetë e tillë që të arrihet prerja tërthore e specifikuar prej betoni monolit ne te gjithe gjatesine e pilotes.
- Betoni do të jetë vetë-kompaktesues pasi nuk do te perdoren vibratore per ngjeshjen e tij.
- Kontraktori duhet te marri te gjitha masat per te garantuar qe aftesia mbajtese e betonit te murit (marka e betonit) nuk demtohet nga humbja e lengut te cementos apo ndarja e elementeve te ngurte te betonit.
- Metoda e derdhjes së betonit duhet të jetë e tillë që të sigurojë që betoni në pozicionin e tij përfundimtar të jetë i dendur dhe homogen. Betoni duhet të hidhet nëpërmjet një hinke me një tub derdhës me një ngurtësi dhe gjatësi të përshatshme për të siguruar që betoni të bjerë vertikalisht dhe në qendër te gropes se panelit te pilotes.
- Hedhja e betonit te behet ne menyre te tille qe ai mos te godase faqet e hekurt ose te dheut.
- Tubi duhet të ketë një gjatësi të mjaftueshme për t'u siguruar që betoni bie lirshëm, fillimi i betonimit bëhet duke mbajtur gryken e derdhjes 50 cm lart fundit të gërmimit.
- Tubat e betonimit duhet te jene te paster, betoni duhet te rrjedhe lirshem, diametri i tubit te betonimit duhet te jete jo me i vogel 8 here diametri maksimal i fraksioneve perberes te betonit.
- Gjatë hedhjes duhen bere kontolle të vazhdueshme te nivelit të betonimit.
- Tubi shkurtohet gjatë procesit cdo 3 m duke u kujdesur që ai të jetë i zhytur në beton dhe mos hyjë bentonit në të.

- Gjatë gjithe kohës së betonimit të një gropë duhet të kemi beton të punueshëm dhe të vazhduar, pa ndërprerje.

FORMIMI I LIDHJEVE

- Për formimin e lidhjeve përdoren kemisha të cilat para se të vendosen duhet të janë të pastruara dhe pa deformime.
- Ato duhet te janë rigjide në mënyrë që mos deformohen gjatë betonimit.
- Nxjerra e kemishave bëhet e tille që mos të dërmtojë faqet e betonimit ne kontakt.
- Formimi i lidhjes dhe kemisha duhet të janë të tillë që të lejojnë paisjen e gërmimit te heqë materialin në faqe të tij.

BETONI

- Betoni i pilotave duhet të ketë klasë fortësie C 25/30 fck, cube =30N/mm².
- Përbërja e betonit në lidhje me materialet dhe raportet e lejuara të recetës do të janë në përputhje me kërkasat e ENV 1332-1.
- Përbajtja e çimentos në betonin strukturor nuk do të jetë më pak se 300kg/m³
- Raporti maksimal i ujit të palidhur/çimento nuk duhet ta kalojë vlerën 0.55 për betonin strukturor.
- Përmasa maksimale e fraksionit agregat nuk duhet të kalojë 20mm.
- Betoni do të ketë një konsistencë të mjaftueshme për të lejuar hedhjen dhe ngjeshjen nëpërmjet metodave të përdorura në formimin e pilotes, por pa largim të tepërt të lëngut të çimentos. Një klasë konsistence 4 ose 5 (konus 18-22cm) është e rekomanduar.
- Të gjithë përbërësit, qe permbahen ne recetën e betonit shtohen/hidhen në nyjen e betonit. Nuk lejohet te shtohet uje ose material tjeter shtese ne kantjer.

ARMATURA E CELIKUT

- Çeliku i armimit duhet të jetë S500 me nivel të naderjes së normuar në rrjedhshmëri prej 500N/mm² dhe zgjatim relativ karakteristik brenda kushteve te lejuara per keto lloj strukturash.
- Çeliku i armimit duhet të depozitohet në kushte të pastra. Ai duhet të jetë i pastër dhe pa skorje korodimi në momentin e fiksimit në pozicion dhe betonimit të mëtejshëm.
- Hekuri i armimit do të jetë në përputhje me EN 1538
- Hekuri duhet të ruajë pozicionin e tij të saktë ne vertikalitet gjatë betonimit të diafragmës, për të lejuar një tolerancë vertikale prej
- +150/-50mm (dmth. një maksimum prej 300mm) mbi nivelin e armimit i cili del mbi ndërprerjen përfundimtare të panelit te murit.

KONTROLLI- MONITORIMI

- Gjate gjithe proceseve te punimeve te zbatohen rregullat nacionale ne fuqi dhe ato te rekomanduara ne eurocode EN 1538: 2003.
- Gjate gjithe fazave te germimit, te kryhet monitorimi permes leximit te inklinometrave dhe monitormi topografik, me frekuence qe percaktohet ne bashkepunim me drejtuesin e punimeve.

**Titulli i
dokumentit:**

“Nderhyrje Emergjente ne Rrugjen “Rexhekri”, Fshati Surrel Nj. A. Dajt”

-Ilustrime

